



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 19

Prishtinë, më 21.07.2008, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje **morën pjesë**: Lulzim Zeneli, Berat Luzha, , Zylfi Merxha, Ibrahim Selmanaj, Myrvete Pantina, Zef Morina, Heset Cakolli, dhe Ali Lajçi.

Munguan : Selvie Halimi, Kosara Nikolić dhe Elheme Hetemi

Pjesëmarrës nga OSBE-ja: Maria Berisha

Pjesëmarrësit tjerë : Nexhat Shatri nga Presidenca

Përfaqësuesit nga ministria: Fadil Musa, Adem Arifaj dhe Isah Rudaku

Nga stafi mbështetës i komisionit : Lule Ymeri, Drita Çarkaxhiu

Mbledhjen e kryesoi : **Lulzim Zeneli**, kryetar i komisionit

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e kaluara,**
- 2. Shqyrtimi i projektligjit për Organizmat e Modifikuar Gjenetikisht,**
- 3. Miratimi i Rekomandimit të komisionit lidhur me gjendjen aktuale të pyjeve në vend.**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi i komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të kaluara.

Kryesuesi, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e dy mbledhjeve, pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për Organizmat e Modifikuar Gjenetikiisht

Kryesuesi, theksoi se materialet e duhura u janë shpërndarë me kohë përfaqësuesve të ftuar për këtë takim.

Fjalën ia dha profesorit të Fakultetit të Bujqësisë.

Shukri Fetahu, dekan i Fakultetit të Bujqësisë. Ai në diskutimin e tij tha se Projektligjin e ka marr me datën 16.07. 2008, mendon se koha ishte e shkurtër për rishikim dhe nga Komisioni kërkoi afat shtesë për rishikimin të Projektligjit. Ai shtoi se gjenetika është një ndër çështjet më të ndjeshme edhe për profesionistët. Për të kontribuar do të bashkëpunojmë me profesionistë të lëmin përkatëse.

Ai propozoi se fjala progjen duhet të jetë – pasardhës, Për këtë term dha sqarim se njëra komponent ka të bëjë me modifikimin e kulturës bujqësore ndërsa tjetra është produkti - pasardhës.

Gjatë punës në grup do ti definojmë kuptimet e neneve dhe do ti ofrojmë me shkrim.

Fadil Musa, Prof. në Fakultetin e Bujqësisë-Gjenetike, e njoftoi Komisionin lidhur për hartimin e Ligjit për OMGJ-të, se sponsoret të këtij P/ligji është Ministria e Bujqësisë.

Grupin punues e përbënin; përfaqësuesit e Ministrisë së Bujqësisë dhe përfaqësuesit e Fakultetit të Bujqësisë të cilët janë profesionalist në këtë lëmi.

Në BE, nuk ka ligj të veçantë për OMGJ-të, dhe theksoi se modelin e kemi marr nga Austria e cila i ka dy rregullore bazë, Rregulloren I- 90/219 dhe II – 90/220.

Gjatë hartimit të P/ligjit jemi bazuar në Rregulloren 90/220, duke e përshtatur në kushtet dhe rrethanat e Kosovës.

Ai tha se kjo është një lëmi shumë specifike që ka të bëjë me modifikimin e kulturave bujqësore siç janë: gruri, misri, elbi etj. Manipulimi gjenetikë ka si pasojë sëmundjen e kancerit, për këtë arsye P/ligji është më se i nevojshëm për vendin tonë.

Versioni i P/ligjit në tri gjuhë ka gabime gjuhësore por gjatë amendamentimit ato mund të përmirësohen.

Berat Luzha – theksoi se jemi të vonuar me procedimin e P/ligjeve. Propozoi se në P/ligj për OMGJ-të, termet e Këshillit shkencorë, emërtimi i Autoritetit kompetent të definohen, ndërsa për termin Këshilli etik thotë se nuk ka vend në këtë P/ligj.

Pasi P/ligji nuk ka vërejtje të mëdha, propozoi që ne si Komision të dalim me amendamentet tona dhe ky P/ligji të shkon në procedurë të rregullt ose të lihet për muajin shtatorë.

Zef Morina- parashtrojë pyetje përfaqësuesve të Ministrisë lidhur me P/ligj, se Autoriteti kompetent a do të jetë në kuadër të departamentit të Ministrisë apo kjo çështje do të rregullohet me akte nënligjore.

Fadil Musa- nënvizoi se Autoriteti kompetent është paraparë të rregullohet me udhëzime administrativ. Shprehjet ‘Këshilli Shkencorë’ dhe ‘Këshilli Etik’ duhet të mbesin në P/ligj, sepse nuk mundet të ndryshohet struktura e Projektligjit.

Kryesuesi, vendosi që komisioni në mbledhjen e radhës me 28.07.2008, do ti shqyrtojë propozimet e ekspertëve dhe të përfaqësuesve të Ministrisë së Bujqësisë, mbi Projektligjin për Organizmat e Modifikuar Gjenetikiisht.

3. Miratimi i Rekomandimit të komisionit lidhur me gjendjen aktuale të pyjeve në vend.

Kryesuesi – i njoftoi anëtarët e komisionit me Propozim – Rekomandimin lidhur me gjendjen e rëndë të Pyjeve në Komunën e Deçanit, nga vizita e realizuar në këtë Komunë.

Më këtë u hap debati lidhur me këtë çështje.

Ali Lajçi – Në bazë të opinioneve që morëm gjatë vizitës në Komunën e Deçanit, mendojë se bëhet fjalë për anarki në mes të Komunës dhe Ministrisë së Mjedisit. Për këtë situatë të krijuar në terren porozi të dalim me Rekomandime. Të ndërpritet për kohë të caktuar prerja e pyjeve, deri në periudhën kur do të kemi një Ligj funksional.

Heset Cakolli – theksoi se propozimet e Rekomandimeve janë me vend. Për pikën e parë të Rekomandimit, lidhur me vendimin e veçantë për ndërprerjen e aktiviteteve legale në Pyje të Deçanit, propozoi të ndermirën masa preventive edhe për pyjet në tërë territorin e Kosovës. Theksoi se një ndër problemet thelbësore është çështja e Agjensionit të Pyjeve dhe çështja e gjykatave. Për këtë propozoi që në rekomandim të futen edhe këto dy segmente.

Zef Morina – Në bazë të komenteve që janë dhënë në Komunën e Deçanit, theksoi se këto pika të paraqitura në propozim janë të përfshira edhe kërkesat tona.

Sa i përket njësisë policore, me këtë kërkesë jemi të hendikepuar, sepse policia dhe rojet e pyjeve duhet të kenë përgjegjësi dhe kompetenca më të mëdha. Pra, për pikën e katërt propozoi të bëhet përpilim më i përshtatshëm.

Berat Luzha – theksoi se në Propozim duhet të shkruhet ‘në territorin e Kosovës’ Në Rekomandim në pikën e parë fjala ‘të gjitha’ të zëvendësohet me ‘përkohësisht’.

Në pikën e dytë para (MBPZHR) të shtohet fjala ‘përkatësisht’.

Në pikën e tretë pas fjalës ‘urgjentisht procedurën’ të shtohen fjalët ‘për hartimin apo’.

Në bazë të gjitha përpjekjeve që ka bërë komisioni shihet se ky Ligj është i pa zbatueshëm dhe propozoi hartimin e P/ligjit të ri.

Kryesuesi në bazë të debatit dhe gjendjes së krijuar në pyjet e Komunës së Deçanit propozoi që Komisioni të nxjerrë këtë:

K o n s t a t i m

Gjendja e pyjeve në vend, në veçanti në komunën e Deçanit është tejet e rëndë duke shkuar drejt një degradimi masiv si rezultat i prerjes ilegale të drunjëve, prandaj i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës të miratojë këtë:

R e k o m a n d i m

I. Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendim të ndërpresë përkohësisht të gjitha aktivitetet legale që ndërlidhen me prerjen e pyjeve në Kosovë, veçanërisht në komunën e Deçanit, (anulimi i tenderit për prerje të drunjëve)

II. Qeveria e Republikës së Kosovës, respektivisht MBPZHR urgjentisht të përgatisë planin menaxhues afatgjatë për pyjet e Kosovës.

III. Qeveria e Republikës së Kosovës të fillojë procedurën për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pyjet (L.nr.2003/3) në pajtim me politikat e Qeverisë së Kosovës.

IV. Qeveria e Republikës së Kosovës të iniciojë procedurën e ristrukturimit të njësisë Rojet e Pyjeve, në përputhje me nevojën dhe gjendjen e krijuar në Kosovë.

4. Të ndryshme

Kryesuesi në të ndryshme, fjalën ia dha përfaqësueses nga OSB-ja që të na njoftoi Komisionin lidhur me kërkesën tonë lidhur me vizitën në Parlamentin Kroat.

Maria Berisha – e njoftoi Komisionin Parlamentar se me datën 20-24 shtator 2008 është caktuar të bëhet vizita në Parlamentin Kroat.

Ditën e parë do të realizohet qëndrimi në Parlament Kroat, ku do të ketë takime me këto Komisione;

1. Komisioni për Planifikim Hapësinor dhe Ndërtimtari.
2. Komisioni për mbrojtjen e mjedisit
3. Komisioni për Bujqësi, peshkim dhe zhvillim Rural
4. Komisioni për Zhvillim Regjional, pylltari dhe menaxhimin e Ujërave.

Në ditën e dytë do realizohet takimi me Ministrin përkatëse dhe një vizitë në terren.

Mbledhja e radhës u caktua me datën 28.07.2008 në ora 11:00 në sallën N-225

Mbledhja përfundoi në orën 11:50

Përgatitu

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit

Lulzim Zeneli